



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2752 / prot
7

Tiranë, më 01.11 2022

VENDIM
Nr. 53, Datë 31/10/ 2022

“PËR

**MIRATIMIN E PAGAVE TË STAFIT AKADEMIK SIPAS VENDIMIN NR. 647,
DATË 05.10.2022 “ PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 748, DATË
11.6.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE
SHTESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT AKADEMIK TË
INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”**

Referuar Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika c, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.115 / 2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 “ Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE “ Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Vendimin nr. 647, datë 05.10.2022 “ Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë” II/pika 2; Vendimit të Senatit Akademik – UT Nr.26 datë 31.10.2022; pas miratimit nga anëtarët e Bordit të Administrimit, Bordi i Administrimit :

Vendosi:

1. Miratimin e pagave të stafit akademik në kufirin maksimal të tyre sipas Lidhjes nr.1-Strukturat dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, të VKM-së nr. 647 datë 05.10.2022.
2. Burimi i financimit mbi kufirin minimal deri në kufirin maksimal të përballohet nga të ardhurat që realizon UT nga shërbimet e tjera.
3. Efektet financiare fillojnë nga data 1 tetor 2022.
4. Ngarkohet Administratori dhe strukturat përgjegjëse në Universitetin e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi. Administratori i UT-së, dhe Administratorët e njësive kryesore të kryejnë procedurat e nevojshme për të mbështetur zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Adda KARAPICI